



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga fshati, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021, KSHPK morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr. 12-2052 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-2052/1 me datë 28.03.2019 dorëzuar nga parashtruesi nga fshati,
NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-2052 nga viti 2019, në rastin e lëndës vepron organ tjetër kompetent

Lënda me numër 12-2052 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-2052 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-2052/1 me datë 28.03.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga fshati

Në denoncimin e dorëzuar flitet për akuza për pakënaqësi nga kryerja e inspektimit të jashtëzakonshëm nga ana e personave zyrtar të punësuar në Inspektoratin i tregut shtetëror pranë Ministrisë së ekonomisë me datë 11.02.2019, në subjektin juridik SHPKNJ – dy shitore në fshatin, në të cilën si menaxhues është personi, i biri i parashtruesit të denoncimit, gjatë së cilës ai ka qenë i obliguar të paguan gjobë prej 2.300 euro përshkak të punës joligjore dhe shitjes së pijeve alkoolike (birrë) pa dokumentacion përkatës për furnizim.

Gjatë rishikimi të rastit të lëndës, KSHPK i merr parashyshë akuzat e denoncimit dhe në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Inspektorati i tregut shtetëror pranë Ministrisë së ekonomisë për informacione dhe të dhëna në lidhje me rastin e lëndës. Pas kërkesës së Komisionit shtetëror janë dorëzuar lajmërim me informacionet e kërkuara në shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për inspektim të jashtëzakonshëm të kryer nga ana e Inspektoratit të tregut shtetëror pranë Ministrisë së ekonomisë me datë 1.02.2019, në bazë të Ligjit për tregëti, mbi personin juridik SHPKNJ – dy shitore në fshatin

....., në të cilën si menaxhues ka qenë personi – i biri i parashtruesit. Sipas parashtruesit, akuzat e inspektorëve nuk kanë qenë të vërteta kurse gjoba edhe ato e kanë paguar, iu është shqiptuar në mënyrë të padrejtë dhe joligjore dhe kërkon që të rishikohet procedura e lëndës. Në shtojcë janë dorëzuar Procesverbale, fletëpagesë

Nga inspektimi, i bërë në dokumentacionin e dorëzuar, KSHPK konstatoi:

- Gjatë inspektimit i bërë nga ana e inspektoratit është vërtetuar gjendja faktike dhe është formuluar procesverbal për procedurën për barazim të ofruar me datë 19.02.2019, dhe gjithashtu janë shqiptuar dy kundërvajtje me fletëpagesa dhe atë: 1) për shitoren për kundërvajtje të kryer për mosmbajtje të evidencës për furnizime dhe shitje në librin tregëtar, në përputhje me Ligjin për tregëti nenin 28 paragrafi 1 kurse dënuar me nenin 57 paragrafi 1 pika 1 në vlerë për gjobë të caktuar prej 1800 euro në kundërvlerë të denarit dhe 2) për shitoren – për kundërvajtje të kryer për mosmbajtje të evidencës për furnizime dhe shitje në librin tregëtar në përputhje me Ligjin për tregëti nenin 28 paragrafi 1 kurse dënuar me nenin 57 paragrafi 1 pika 1, në vlerë prej 540 euro në kundërvlerë të denarit, të cilët vepruesi i kundërvajtjes është duhur ta paguajnë në afat prej 8 ditë nga dita e pranimit të urdhërit (fletëpagesën) për kundërvajtje.

Procesverbali për procedurën e ofruar për barazim dhe fletëpagesën për kundërvajtje iu është dorëzuar kryesve të veprës me postë, me çka menaxhuesi i shoqërisë nuk është paraqitur në terminin e caktuar për procedurën e ofruar dhe nuk i ka nënshkruar të njëjtat, por i është treguar se nëse nuk e bënë pagesën e gjobës në afatin e caktuar me ligj do t'i ngritet procedurë për kundërvajtje.

Me datë 06.07.2020, me kërkesë të KSHPK është marrë informim nga Inspektorati i tregut shtetëror pranë Ministrisë së ekonomisë me të cilën lajmëron se me datë 11.02.2019 është bërë inspektim i jashtëzakonshëm në shitoren për tregëti me pakicë – kolonial në fshatin në përbërje të SHTNUT SHPKNJ për të cilën është bërë procesverbal. Lëndë e inspektimit kanë qenë dispozitat nga Ligji për tregëti gjegjësisht udhëheqja e evidences tregëtare për furnizime dhe shitje të mallit në përputhje me nenin 28 paragrafi 1. Më konkretisht, lëndë e inspektimit kanë qenë furnizimet me mall nga birra SHPKNJ dhe udhëheqja e evidences tregëtare për të njëjtat për periudhën prej 01.01.2018 deri 13.11.2018.

Gjatë inspektimit është konstatuar se tregëtari është furnizuar me mall i cili nuk është evidentuar në librin tregëtar, kurse gjendja e caktuar është vërtetuar edhe me inspektim në evidencën tregëtare tek kontabilisti i autorizuar. Pas kësaj gjendje të caktuar është vepruar në përputhje me nenin 57 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për tregëti, me çka kryesit të kundërvajtjes i është ofruar procedure për barazim kurse vlera e lartësisë së gjobës është bërë në përputhje me Ligjin për kundërvajtje, ku merret parasyshtë parametrat: të ardhurat e përgjithshme të realizuara në viti fiskal paraprak, numri mesatar i të punësuarve dhe sjelljet paraprake të kryesve, ashtu që është caktuar gjobë përkatëse me sasisnë e punës së ndërmarrjes. Kryesi i kundërvajtjes e ka pranuar procedurën për barazim dhe në afatin e caktuar me ligj ka paguar gjobën për kundërvajtje.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se për rastin e lëndës është vepruar nga organ tjetër kompetent dhe është konstatuar kundërvajtje, kurse nga ana e

kryesit të veprës është pranuar oferta për procedurë për barazim, me çka vlerëson se KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 12 shkurt të viti 2021 me numër 12-2118/3

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: J. C., këshilltarë

Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**

